

Бр.Нр. 12-3710/1
29 MAR 2024 20 год./viti

СКОПЈЕ - ШКУП

Në bazë të nenit 24-a paragrafit 17 të Ligjit për Arsimin e Mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/ 03, 42/03, 67/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/ 10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13 dhe 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.229/20), ministri i Arsimit dhe Shkencës përcaktoi

RREGULLORE

për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën dhe kriteret më të përafërta të organizimit dhe realizimit të garave të nxënësve në lëndë të caktuara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin e mesëm

Neni 1

Në Rregulloren për mënyrën dhe kriteret më të afërta për organizimin dhe realizimin e garave të nxënësve në lëndë të caktuara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin e mesëm nr.19-2249/1 të datës 05.03.2013, nr.20-2928/1 të datës 02.03.2017, nr.13-5583/1 të datës 29.03.2021 dhe nr.13-5583/2 të datës 31.03.2021, neni 5 ndryshohet dhe thotë:

"1.Për organizimin e garave, shoqata e mësimdhënësve parashtronë kërkesë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) për akreditimin dhe organizimin e garave pas publikimit të Thirrjes publike.

2.Thirrja publike nga paragrafi 1 i këtij neni publikohet në ueb faqën e Ministrisë në tremujorin e parë të vitit.

3.Gjatë parashtrimit të kërkesës për akreditimin e shoqatave të mësimdhënësve dorëzojnë statut, rregullore për organizimin e garave dhe kalendar trevjeçar për zbatimin e garave për nxënësit në shkollat e mesme dhe dokumentacionin nga neni 24a paragrafi 8 i Ligjit për Arsimin e Mesëm.

4.Nëse në Thirrjen Publike paraqiten dy ose më shumë shoqata të cilat i plotësojnë kushtet konform nenit 24-a paragrafit 8 të Ligjit për Arsimin e Mesëm, Komisioni për Akreditimin e Shoqatave të Mësimdhënësve vendos në bazë të kriterëve plotësuese, edhe atë:

-numri i mësimdhënësve të cilët janë anëtarë të shoqatës,

-numri i mësimdhënësve nga shoqata që si mentorë kanë marrë pjesë në gara ndërkombëtare/ olimpiada dhe

-çmimet e fituara për vendet e fituara në gara ndërkombëtare/olimpiada ku si mentorë kanë qenë mësimdhënës nga shoqata.

5.Shoqata e mësimdhënësve për organizimin e garave akreditohe për një periudhë trevjeçare.

6.Për organizimin e garave akreditohe një shoqatë e mësimdhënësve në lëndë mësimore të caktuar.

7.Pjesëmarrja e nxënësve në garat për lëndë të caktuara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin e mesëm është vullnetare dhe falas, gjegjësisht nuk paguhet kompensim në të holla nga prindërit/kujdestarët e nxënësve.

8.Shkolla planifikon garat në programin vjetor për punë.

9.Shoqata e akredituar e mësimdhënësve në ueb faqën e tyre publike çdo vit publikojnë pyetjet, detyrat dhe/ose temat të cilat janë përdorur gjatë garave të realizuara të nxënësve në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror të garave të vitit paraprakë, të cilat duhet të përkthehen në të gjitha gjuhët mësimore."

Neni 2

Pas nenit 5, shtohet neni ri 5-a, i cili thotë:

„Neni 5-a

Shoqatat e akredituara të mësimdhënësve, në kalendarin trevjeçar për realizimin e garave për nxënësit e shkollave të mesme në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror, përcaktojnë datat e mbajtjes së garave më datë të dytë opsionale, me qëllim që në të njëjtën ditë ose të në të njëjtën kohë të mos mbahet më shumë se një garë e nxënësve dhe të njejtat t'i publikojë në ueb faqen e shoqatës së akredituar dhe për të njëjtën gjë të njoftojë Ministrinë.

Ministria në ueb faqën e saj publikon Kalendarin për zbatimin e garave për nxënësit e shkollave të mesme në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror”.

Neni 3

Në nenin 6, paragrafin 2, pas alines 1, shtohet paragraf i ri 2, i cili thotë:

“-nëse shoqata e mësimdhënësve kërkon kompensim në të holla nga prindërit/kujdestarët e nxënësve për pjesëmarrjen në garave në lëndë të caktuara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror;”

Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e sjelljes së tij.

Бр./Nr. 12-3710/

29 MAR 2024 2024 година
Скопје

Министер за образование и наука
Ministër i Arsimit dhe Shkencës
Doc. Dr. Jeton Shaqiri

